

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KRU"BIFURKACIONI"SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit nr. **600-KRU"BIFURKACIONI"SH.A.-25-11522-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ritender:Furnizim me Eskavator - Skip (2 makineri të reja)**

ANKESË (Për herën e Tretë)

1. Identifikimi i ankuesit*

Agribau SHPK

Adresa: Rr. Lidhja e Pejës nr.136 Prishtinë

PRISHTINE, 10000

044/360 324

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Lulzim Berisha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

agribau.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

14.09.2026

(Data e parashtrimt të ankesës)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- Njoftimi per kontrate 24.12.2025
- Afatit per dorezimin e Ofertave 03.02.2026 14:00
- Kriteri per dhenje te Kontrates; Çmimi me i Ulët
- B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve 04.02.2026 15:49
- B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-se 03.03.2026
- Kerkesa per qasje ne dokumente zyrtare 04.03.2026
- Qasja ne dokumente zyrtare, e derguar permes email nga AK 04.03.2026
- Kerkesa per rishqyrtim te vendimit 09.03.2026
- Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim 11.03.2026
- Ankesa e derguar nga Agribau SHPK ne OSHP date:23.03.2026
- Vendimi i OSHP-së:2026/0181 date: 16.04.2026 (Aprovim i Ankeses)
- Njoftimi mbi vendimin e AK-se date:28.04.2026 (Agribau Shperblehet me kontrate)
- Vendim mbi Pezullimin e Aktivitetit Të Prokurimit, date;05.05.2026
- Vendim mbi Refuzumin e Kërkesës Për Ri-Shqyrtim, date: 06.05.2026 (Bojku B.I.)
- Vendim I AK-se mbi Pezullimin e Aktivitetit, Ankese OSHP, date: 08.05.2026 (Bojku B.I.)
- Vendimi i OSHP-së:2026/0303(Aprovim i Pajtit të Palëve për ankesën e OE Gazmend Bojku B.I.)
- Njoftim mbi vendimin e AK-së dhe Letrat Standarde, date:19.06.2026
- Kerkesa per qasje ne dokumente zyrtare 22.06.2026
- Kerkesa per rishqyrtim te vendimit 24.06.2026
- Vendim i AK-së, Refuzum i Kërkesës për Ri-Shqyrtim, për Agribau shpk date; 26.06.2026
- Ankesa e derguar nga Agribau SHPK ne OSHP date:03.07.2026
- Vendimi i OSHP-së:2026/0454 date: 07.08.2026 (Aprovim i Ankeses)
- B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-se 28.08.2026
- Kerkesa per Rishqyrtim date;02.09.2026
- Vendim i AK-së, Refuzum i Kërkesës për Ri-Shqyrtim, për Agribau shpk date; 04.09.2026
- Kerkesa per qasje ne dokumente zyrtare, (komunikimi me WhatsApp) 07.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve,

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐



Ne mbështetje të nenit 108A të LPP-se ne me date 02.09.2026 kemi kërkuar nga AK të beje Rishqyrtim të Vendimit të dates 28.08.2026 për eliminim të kompanise tone, mirpo kjo kerkese eshte refuzuar.

AK ka konsideruar se pretendimet ankimore nuk jan te bazuara.

Bashkangjitur ;Kërkesën për ri-shqyrtim, Vendimin mbi kërkesen për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 1- Qëllimi,

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 28- Specifikimet teknike,

Neni 52 -Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

7. Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.

Neni 59- Egzaminimi ,Vlerësimi,dhe Krahësimi i Tenderëve,

Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtese.

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve RREGULLOREN Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

Neni-in 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Neni 97 Shkeljet e rënda RREGULLOREN Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pakenaqur me vendimin e datës 04.09.2026 mbi refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim nga AK- **KRU" BIFURKACIONI"SH.A.** në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **"Ritender:Furnizim me Eskavator - Skip (2 makineri të reja) "** me nr. të prokurimit: **600-KRU" BIFURKACIONI"SH.A.-25-11522-1-1-1** në afatin ligjor konform nenit 109 të LPP-së, prane OSHP-se për herën e Tretë ushtrojmë këtë:

ANKESË

Me date 28.08.2026 AK ka derguar dokumentin B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me të cilin vendim është shpërblyer me kontratë OE Gazmend Bojku B.I. me Çmim prej 174,400.00 euro, dhe është Eliminuar nga ky aktivitet kompania Agribau SHPK, e cila kishte oferten prej 147,783.20 që do të thotë se Oferta e OE-se se shpallur fitues ishte me e lartë me difference prej 26,616.80 euro apo 18%.



Sipas Letrës Standarde dhe Njoftimit për vendim të AK-së, oferta jonë është eliminuar me arsyetimin:

Arsyetim

Operatori Ekonomik "AGRI BAU SH.P.K., Rr. Lidhja e Pejës nr.136, 10000, Prishtinë" për tenderin: **Ritender: Furnizim me Eskavator - Skip (2 makineri të reja)**, ka ofertuar me çmim prej 147,783.20€. Pas ankesës së Operatorit Ekonomik dhe shqyrtimit nga OSHP, në Raportin e Ekspertit Shqyrtues për lëndën nr. 2026/0303, është konstatuar se Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë kontroll dhe verifikim efektiv të dokumentacionit teknik, në pajtim me nenin 52, paragrafi 7 të LPP-së, veçanërisht lidhur me pretendimet për mospërputhje ndërmjet katalogut të dorëzuar nga OE dhe dokumentacionit të prodhuesit.

Në zbatim të këtij udhëzimi, Komisioni gjatë rivlerësimit ka kërkuar nga prodhuesi verifikimin e katalogut dhe specifikimeve teknike të modelit të ofertuar SHANMON 388T. Prodhuesi ka konfirmuar pranimin e kërkesës së Komisionit përmes komunikimit në WhatsApp dhe më pas ka përcjellë katalogun teknik të modelit përkatës. Nga krahasimi i katalogut të dorëzuar nga AGRI BAU SH.P.K. me katalogun e përcjellë nga prodhuesi, Komisioni ka evidentuar këto mospërputhje:

Pozicioni 16 – Gjatësia: kërkesa në Dosjen e Tenderit: maksimum 580 cm; në ofertë është paraqitur 5800 mm, ndërsa në katalogun e verifikuar nga prodhuesi figuron 6050 mm (605 cm).

Pozicioni 18 – Gjerësia: kërkesa në Dosjen e Tenderit: maksimum 245 cm apo 2450 mm; në ofertë është paraqitur 2297 mm apo 229.7 cm, ndërsa në katalogun e verifikuar nga prodhuesi figuron 2484 mm (248.4 cm). Pra, të dhënat e verifikuara nga prodhuesi tregojnë se makineria nuk i përmbush dy kërkesa teknike të detyrueshme të Aneksit 1, pasi gjatësia dhe gjerësia tejkalojnë kufijtë maksimalë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Këtij Vendimi për eliminimin e AGRIBAU SHPK, AK poashtu i ka bashkëngjitur edhe kërkesën drejtuar prodhuesit, të dërguar përmes email-it si më poshtë:

Emaili i dërguar nga AK tek prodhuesi:

me: sh.p.k.agribau@agribau.com
 To: sh.p.k.agribau@agribau.com, sh.p.k.agribau@agribau.com, sh.p.k.agribau@agribau.com, sh.p.k.agribau@agribau.com, sh.p.k.agribau@agribau.com

Dear Sir/ Madam,

We are contacting you on behalf of KRU "BIFURKACIONI" J.S.C., Kosovo, regarding the Shanmon 388T Backhoe Loader offered within a public procurement procedure in Kosovo.

The purpose of this email is to request an official confirmation from the manufacturer regarding an apparent discrepancy between two technical specifications for the Shanmon 388T.

According to the official technical specifications published on the manufacturer's website, the overall dimensions of the 388T are stated as:

Overall dimension (L x W x H): 6050 x 2297 x 3465 mm

However, in the technical documentation submitted by an Economic Operator within the above-mentioned procurement procedure, the same model Shanmon 388T is presented with the following dimensions:

Overall dimension (L x W x H): 5800 x 2297 x 3844 mm

The difference is therefore as follows:

- Official manufacturer specification: 6050 mm overall length
- Technical document submitted by the Economic Operator: 5800 mm overall length
- Difference: 250 mm

The procurement technical requirement for this item is:

Overall length maximum 5800 mm.

Therefore, in order to carry out an effective technical verification, we kindly request your official confirmation on the following:

- Are both specifications 6050 x 2297 x 3465 mm and 5800 x 2297 x 3844 mm officially stated/published by Shanmon for the model 388T?
- If both specifications are authentic, do they refer to different configurations, versions, production years or equipment arrangements of the Shanmon 388T?
- Is there an officially manufactured Shanmon 388T configuration with an overall length of 5800 mm, as stated in the technical documentation submitted by the Economic Operator?
- If such a 5800 mm configuration exists, please provide or clarify the official manufacturer catalogue, technical datasheet or document in which this specification is stated.
- Please confirm the complete official dimensions L x W x H of the specific 388T configuration corresponding to the 5800 mm length.
- Please clarify whether the difference in dimensions can result from different attachments, buckets, telescopic arm configurations, tyre, chain's configurations or other factory-installed equipment.
- If possible, please confirm which of the two configurations corresponds to the following specifications submitted by the Economic Operator:

- Operating weight: 9100 kg
- Overall dimension: 5800 x 2297 x 3844 mm
- Load breakout force: 47 kN
- Load lifting capacity: 2500 kg
- Bucket unloading height: 2807 mm
- Buckets digging force: 40.8 kN
- Maximum digging speed: 5245 mm
- Engine: Cummins Euro III Q583.9-C100
- Rated power: 74 kW
- Maximum torque: 300 Nm
- Displacement: 3.9 L
- Pump displacement: 63 ml/r
- Pump type: Gear pump
- Maximum travel speed: 38 km/h
- Loading hydraulic system pressure: 20 MPa
- Excavation hydraulic system pressure: 20 MPa

8. Finally, please confirm whether the technical document containing the specifications 5800 x 2297 x 3844 mm is an authentic Shanmon document reviewed or authorized by your company.

We kindly request that your response be provided on an official company letterhead, signed by an authorized representative of the manufacturer, clearly indicating the representative's name and position.

This confirmation is required solely for the purpose of technical verification of the submitted tender documentation and will be used by the Contracting Authority during the evaluation/selection process.

For reference, we can provide you with both technical documents referred to above.

We would greatly appreciate your official confirmation at your earliest convenience.

Kind regards!

KRU "BIFURKACIONI" J.S.C.
 Kosovo

Best regards,



Me date 02.09.2026 ne si Agribau SHPK kemi bere Kerkese per Rishqyrtim pran AK-se dhe Me date 04.09.2026 AK ka marrur vendim per Refuzim Kerkesen tone per Rishqyrtim me arsyetimin si me poshte;

Arsyetim

Operatori Ekonomik AGRI BAU SH.P.K., Rr. Lidhja e Pejës nr.136, 10000, PRISHTINË, si palë e pakënaqur ka parashtruar kërkesë për Ri-shqyrtim tek Autoriteti Kontraktues me datë 02.09.2026 kundër Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: Ritender: Furnizim me Eskavator - Skip (2 makineri të reja), me nr. prokurimi 600 KRU"BIFURKACIONI"SHA.-25-11522-1-1-1 dhe nr. të brendshëm 600.25.049.111, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik:

Adresa: Rr. Enver Topalli 45, Ferizaj 70000

1. Fakti që komunikimi me prodhuesin SHANMON është zhvilluar pjesërisht përmes WhatsApp-it nuk e ndryshon faktin se informacioni teknik është kërkuar dhe siguruar drejtpërdrejt nga vetë prodhuesi. Autoriteti Kontraktues nuk është mbështetur vetëm në komunikimin përmes WhatsApp-it, por në dokumentacionin teknik të përcjellë nga prodhuesi. Andaj, pretendimi se ju jeni eliminuar vetëm mbi bazën e komunikimit përmes WhatsApp-it është i pabazuar, pasi vendimi është mbështetur në të dhënat teknike të konfirmuara nga vetë prodhuesi dhe në mospërputhjen e tyre me kërkesën e detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

2. Pas kthimit në ri-vlerësim të aktivitetit të prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka kryer verifikim shtesë të karakteristikave teknike të modelit të ofruar SHANMON 388T, me qëllim të konfirmimit të përputhshmërisë së tij me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Për këtë qëllim, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarim dhe dokumentacion teknik drejtpërdrejt nga prodhuesi SHANMON. Dokumentacioni i përdorur për verifikim nuk është marrë nga interneti, burime të treta apo burime të paautorizuara, por është siguruar nga vetë prodhuesi, si burimi primar i informacionit për produktin. Sipas katalogut teknik të dërguar nga prodhuesi, të cilin e kemi ngarkuar në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 28.08.2026, të cilin e gjeni si dokument shtesë në sistemin elektronik e-prokurimi, dimensionet e modelit janë 6050 x 2297 x 3465 mm, ndërsa në ofertën e OE AGRIBAU SH.P.K. është deklaruar gjatësi prej 5800 mm. Dosja e Tenderit përcakton qartë kërkesën: "Gjatësia e përgjithshme – maksimum 5800 mm." Rrjedhimisht, gjatësia prej 6050 mm, e konfirmuar nga vetë prodhuesi, tejkalon për 250 mm kufirin maksimal të lejuar dhe paraqet mospërputhje me kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit. Autoriteti Kontraktues është bazuar në dokumentacionin teknik të siguruar drejtpërdrejt nga prodhuesi, ndërsa komunikimi me të ka shërbyer vetëm për verifikimin e karakteristikave reale të produktit, pa ndryshuar apo plotësuar ofertën. Pra bazuar në të dhënat e ofertës, kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe konfirmimin e prodhuesit, modeli SHANMON 388T nuk e përmbush kërkesën për gjatësi maksimale 5800 mm. Andaj, pretendimet e juaja ankimore ne si KRU Bifurkacioni SHA i marrim si të pabazuara, dhe në këtë mënyrë e refuzojmë kërkesën tuaj për Ri-shqyrtim.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtror ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues KRU BIFURKACIONI SH.A. nuk e ka zbatuar në mënyrë substanciale dhe efektive Vendimin e OSHP-së nr. 454/26, por vetëm formalisht ka ndërmarrë një komunikim me SHANMON-in, pa kryer verifikimin konkret dhe të drejtpërdrejtë të ofertës së AGRIBAU SH.P.K. për të cilin ishte i nevojshëm ky verifikim.

Vendimi i OSHP-së kishte për qëllim që çështja e përputhshmërisë teknike të SHANMON 388T të sqarohej përmes prodhuesit, në mënyrë që të përcaktohej nëse makineria konkrete e ofruar nga AGRIBAU SH.P.K. i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit. Mirëpo, Autoriteti Kontraktues nuk e ka orientuar verifikimin drejt ofertës konkrete të AGRIBAU SH.P.K., nuk e ka identifikuar në mënyrë të qartë konfigurimin konkret të makinës së ofertuar dhe, më pas, është mbështetur në dokumentacion të një konfigurimi tjetër të modelit SHANMON 388T.



AK argumenton se ka kontaktuar prodhuesin dhe se ka marrë dokumentacion teknik, por nuk dëshmon se prodhuesit i është dërguar dokumentacioni i AGRIBAU-së dhe se është kërkuar konfirmimi i konfigurimit konkret të ofertuar nga AGRIBAU.

Për më tepër, vetë AK pranon se komunikimi është zhvilluar përmes WhatsApp-it dhe se nga ky komunikim është siguruar dokumentacioni mbi të cilin është mbështetur vendimi.

Për këtë arsye, është e domosdoshme që në shqyrtimin e kësaj ankese të administrohet komunikimi i plotë dhe origjinal ndërmjet AK-së dhe SHANMON-it.

Mënyra e veprimit të Autoritetit Kontraktues cenon parimet e trajtimit të barabartë, transparencës, proporcionalitetit dhe shqyrtimit objektiv të ofertës, si dhe detyrimin për vlerësim të ofertës mbi bazën e dokumentacionit dhe fakteve që i përkasin ofertës konkrete.

Në veçanti, kërkohet respektimi i dispozitave për shqyrtimin dhe sqarimin e ofertave, përfshirë dispozitat përkatëse të LPP-së lidhur me sqarimin e ofertave dhe verifikimin e dokumenteve, pa lejuar ndryshim material të ofertës.

Po ashtu, vendimi i OSHP-së nr. 454/26 duhet të zbatohet në mënyrë substanciale dhe efektive. Kontakti formal përmes Whatsapp me një burim të përgjithshëm për modelin 388T, pa identifikuar konfigurimin konkret të ofertës së AGRI BAU SH.P.K., nuk mund të konsiderohet se verifikimi është kryer mjaftueshem.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar verifikimin e kërkuar pas procedurës së mëparshme pranë OSHP-së, si dhe me faktin se për eliminimin e ofertës së AGRI BAU SH.P.K. është përdorur dokumentacion që sipas prodhuesit SHANMON i përket një konfigurimi tjetër të modelit 388T dhe jo konfigurimit konkret të ofruar nga AGRI BAU SH.P.K.

Në Vendimin e datës 04.09.2026, Autoriteti Kontraktues pranon se komunikimi me SHANMON ka përfshirë edhe WhatsApp, ndërsa pretendon se vendimi është bazuar në dokumentacion teknik të marrë nga prodhuesi.

AGRI BAU SH.P.K. nuk pretendon se vetëm përdorimi i WhatsApp-it e bën automatikisht komunikimin të pavlefshëm. Çështja kryesore është se kujt i është drejtuar kërkesa, çfarë konfigurimi është verifikuar dhe nëse dokumentacioni i marrë i përket pikërisht makinës së ofruar nga AGRI BAU SH.P.K.

Sipas arsyetimit të Autoritetit Kontraktues, një katalog i marrë përmes WhatsApp-it gjatë verifikimit tregon dimensione 6050 x 2297 x 3465 mm, ndërsa në ofertën e AGRI BAU SH.P.K. është deklaruar gjatësi 5800 mm.

Mirëpo, këto të dhëna nuk provojnë vetvetiu se konfigurimi konkret i ofruar nga AGRI BAU SH.P.K. nuk i përmbush kërkesat e tenderit, nëse dokumentacioni i përdorur nga Autoriteti Kontraktues i përket një konfigurimi tjetër të 388T.

KONFIRMIMI ZYRTAR I PRODHUESIT SHANMON

Për të eliminuar këtë paqartësi, SHANMON ka lëshuar konfirmim zyrtar të datës 01.09.2026, të nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi.

Në këtë konfirmim, prodhuesi sqaron se ka konfigurime të ndryshme të SHANMON 388T dhe se katalogu i marrë më parë përmes një agjenti online nuk është dokumentacioni zyrtar teknik i aplikueshëm për konfigurimin konkret të ofruar nga AGRI BAU SH.P.K.



Prodhuësi identifikon si person përgjegjëse për verifikimin teknik z. Coral Ma, me emailin zyrtar coral@shanmonkj.com, dhe kërkon që verifikimi të bëhet me personin përgjegjëse të prodhuesit dhe jo me një agjent tjetër online.

SHANMON konfirmon gjithashtu se konfigurimi i ofruar nga AGRI BAU SH.P.K. është konfigurimi i përzgjedhur për këtë tender, se dokumentacioni i dorëzuar nga AGRI BAU SH.P.K. është autentik dhe se konfigurimi i ofruar është përgatitur për të përmbushur kërkesat teknike të tenderit.

Prodhuësi ka konfirmuar edhe se më herët, më 23.06.2026, kishte lëshuar Manufacturer's Declaration / Declaration of Compliance për SHANMON 388T të ofruar nga AGRI BAU SH.P.K.

Pretendimet tona në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 02.09.2026 kundër Vendimit të datës 28.08.2026 ishin si më poshte;

Në këtë kërkesë shihet qartë se ju, si Autoritet Kontraktues (AK), në asnjë moment nuk e keni kërkuar nga prodhuësi, dhe as nuk e keni vënë në dijeni atë, se kjo kërkesë për sqarim ka të bëjë me ofertën e dorëzuar nga AGRIBAU SHPK. Ju vetëm keni kërkuar sqarim lidhur me modelin 388T, pa e specifikuar se bëhet fjalë për ofertën e dorëzuar nga AGRIBAU SHPK në kuadër të kësaj procedure të prokurimit.

Po ashtu, shihet qartë se ju keni kërkuar që përgjigjja e prodhuesit të paraqitet në formën e një dokumenti të vulosur dhe të nënshkruar nga prodhuësi dhe të dërgohet përmes e-mailit. Mirëpo, pavarësisht kësaj kërkeje, ju keni pranuar një komunikim të zhvilluar përmes WhatsApp-it dhe e keni konsideruar atë si dëshmi të mjaftueshme për marrjen e vendimit për eliminimin e AGRIBAU SHPK.

Pas marrjes së informacionit për komunikimin e AK-së me Whatsapp, AGRIBAU SH.P.K. ka kontaktuar personin përgjegjëse të SHANMON, znj. Coral Ma, me të cilën AGRIBAU ka komunikim zyrtar lidhur me produktin dhe konfigurimin e ofruar, ku këtë email kemi percjellur edhe tek zyrtaret e prokurimit dhe komisionit vlerësues të AK-së. Si rezultat, SHANMON ka lëshuar më 01.09.2026 dokumentin zyrtar "SHANMON – OFFICIAL MANUFACTURER'S CONFIRMATION", të nënshkruar dhe të vulosur, në të cilin sqarohet drejtpërdrejt çështja e ngritur nga AK. (kete dokument bashkangjesim kerkese per Rishqyrtim).

Për më tepër, SHANMON ka konfirmuar se kishte lëshuar më herët, më 23.06.2026, një Manufacturer's Declaration/Declaration of Compliance për SHANMON 388T të ofruar nga AGRIBAU SH.P.K. Dokumenti i datës 01.09.2026 shërben si rikonfirmim dhe sqarim i kësaj gjendjeje. (dokumentin e derguar nga prodhuësi date 23.06.2026 po ashtu bashkangjesim kesaj kerkese per Rishqyrtim).

Në këtë konfirmim, SHANMON deklaron se katalogu i marrë nga një agjent online nuk është dokumentacioni zyrtar i aplikueshëm për konfigurimin konkret të SHANMON 388T të ofruar nga AGRIBAU SH.P.K. dhe se SHANMON ka konfigurime të ndryshme të modelit 388T.

Po në këtë dokument, SHANMON konfirmon se dokumentacioni që korrespondon me konfigurimin e ofruar nga AGRIBAU është përgatitur dhe publikuar nga SHANMON dhe se makina e ofruar nga AGRIBAU është konfigurimi specifik i zgjedhur dhe i konfirmuar nga SHANMON për këtë tender, për të përmbushur kërkesat teknike të tenderit dhe se i përmbush të gjitha specifikimet teknike të detyrueshme.



Pretendimi 1.

Kërkesa për verifikim e AK-së ndaj prodhuesit nuk ka qenë e formuluar dhe e drejtuar në mënyrë të plotë për ofertën konkrete të Agribau sh.p.k.

Kërkesa jonë mbështetet në faktin se konstatimi i AK-së është rezultat i një procedure verifikimi të paplotë dhe jo të orientuar ndaj ofertës konkrete të AGRIBAU SH.P.K.

Verifikimi është bazuar në një komunikim me një person tjetër i cili nuk është përgjegjës për ofertën e Agribau SHPK përmes WhatsApp-it dhe në një katalog tjetër të modelit 388T, ndërkohë që vetë prodhuesi SHANMON, përmes personit përgjegjës me të cilin AGRIBAU SHPK ka komunikim zyrtar, ka konfirmuar se modeli 388T ekziston në konfigurime të ndryshme dhe se konfigurimi i ofruar nga AGRIBAU SHPK për këtë tender i përmbush kërkesat teknike. Nga dokumentacioni i administruar nga vetë Autoriteti Kontraktues rezulton se AK i është drejtuar prodhuesit SHANMON për të kërkuar verifikim lidhur me modelin SHANMON 388T.

Megjithatë, kërkesa nuk e ka identifikuar në mënyrë të qartë dhe të plotë se verifikimi kishte të bënte me ofertën konkrete të paraqitur nga AGRIBAU SH.P.K. në këtë procedurë, as nuk i ka paraqitur prodhuesit të dhënat e nevojshme për të identifikuar konfigurimin konkret të makinës së ofruar nga AGRIBAU.

Në këto rrethana, një kërkesë e përgjithshme për informacion lidhur me "SHANMON 388T", pa identifikuar qartë ofertën e AGRIBAU SH.P.K., konfigurimin konkret dhe dokumentacionin që duhet të verifikohej, nuk garanton që përgjigjja e prodhuesit do t'i referohet pikërisht makinës së ofruar nga AGRIBAU SHPK.

Nëse AK synonte të verifikonte autenticitetin dhe përputhshmërinë e ofertës së AGRIBAU SH.P.K., kërkesa duhej të ishte e qartë dhe e individualizuar, duke i treguar prodhuesit se:

-Ofertuesi është AGRIBAU SH.P.K.;

-AGRIBAU ka ofruar SHANMON 388T në këtë procedurë, dhe duhej treguar se cili është konfigurimi/dokumentacioni konkret i dorëzuar me ofertë nga AGRIBAU SHPK dhe prodhuesit të i kërkohej të konfirmojë nëse pikërisht ky konfigurim i dorëzuar në ofertë nga Agribau SHPK i plotëson kërkesat teknike të tenderit.

Mungesa e këtyre të dhënave ka rëndësi të drejtpërdrejtë në këtë rast, sepse ka krijuar kushtet për një keqidentifikim të konfigurimit dhe për marrjen e një përgjigjeje nga një person tjetër jo përgjegjës për ofertën e Agribau SHPK, i cili nuk ka pasur informacionin e plotë se për cilën ofertë dhe cilin konfigurim konkret bëhej fjalë.

Ky veprim nuk mund të konsiderohet si verifikim përfundimtar i ofertës së AGRIBAU SH.P.K., sepse nuk provohet se personi që është përgjigjur në WhatsApp ka qenë personi përgjegjës për konfigurimin konkret të makinës së ofruar nga AGRIBAU dhe, mbi të gjitha, nuk provohet se atij personi i është bërë e ditur se po verifikohej pikërisht oferta e AGRIBAU SH.P.K.

Konfirmimi zyrtar i prodhuesit e sqaron përfundimisht keqkuptimin e krijuar nga verifikimi i AK-së, dhe se katalogu i dorëzuar nga Agribau është autentik.

SHANMON ka konfirmuar gjithashtu se katalogu teknik i dorëzuar nga AGRIBAU SH.P.K. së bashku me ofertën korrespondon me dokumentacionin teknik të përgatitur dhe/ose publikuar nga SHANMON për konfigurimin përkatës të 388T.



Prodhuesi ka deklaruar shprehimisht se AGRIBAU SH.P.K. nuk e ka prodhuar, falsifikuar apo ndryshuar teknikisht katalogun dhe se specifikat teknike të përfshira në të janë bazuar në informacionin e lëshuar nga SHANMON dhe të publikuar përmes kanaleve të tij zyrtare.

Dallimi ndërmjet dy katalogëve nuk provon mospërputhje të ofertës së Agribau SHPK
Fakti se AK ka gjetur një katalog tjetër për modelin 388T, me dimensione të ndryshme nga ato të dokumentacionit të paraqitur nga AGRIBAU, nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar se oferta jonë është e Papërgjegjshme.

Vetë prodhuesi ka sqaruar se ekzistojnë konfigurime dhe versione të ndryshme të 388T dhe se specifikat mund të ndryshojnë ndërmjet tyre. Prandaj, krahasimi i dy katalogëve të konfigurimeve të ndryshme nuk mund të shërbejë si provë se njëri prej tyre është i rremë ose se oferta e AGRIBAU nuk i plotëson kërkesat e tenderit.

Pyetja që duhej t'i bëhej prodhuesit nga ana e zyrtarit të komisionit vlerësues duhej të ishte konkrete: nëse konfigurimi i SHANMON 388T i ofruar nga AGRIBAU SH.P.K., sipas dokumentacionit të dorëzuar me ofertë, i përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Ky veprim i komisionit vlerësues të AK-se është në kundërshtim me Neni 59 i LPP-së i cili përcakton se **gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sqarime me shkrim për aspektet e tenderit, por pa kërkuar apo pranuar ndryshim material të tenderit. Po ashtu, tenderi duhet të vlerësohet mbi kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit.**

Në këtë rast, problemi nuk qëndron në faktin që AK ka kërkuar verifikim, por në faktin se verifikimi i përdorur për eliminimin e AGRIBAU nuk është orientuar në mënyrë të mjaftueshme ndaj ofertës konkrete të AGRIBAU dhe konfigurimit konkret të dorëzuar me ofertë.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha faktet e mësipërme, konsiderojmë se eliminimi i ofertës së AGRIBAU SH.P.K. nuk është i mbështetur në një verifikim të plotë, objektiv dhe të drejtpërdrejtë të konfigurimit konkret të ofruar.

Në veçanti, Autoriteti Kontraktues ka krahasuar dokumentacionin e ofertës së AGRIBAU me një katalog tjetër të modelit 388T, të marrë përmes një personi tjetër, pa u siguruar paraprakisht që personi dhe dokumentacioni i përdorur për verifikim i referoheshin konfigurimit konkret të ofertuar nga AGRIBAU.

Ndërkohë, prodhuesi zyrtar SHANMON ka sqaruar se ekzistojnë konfigurime të ndryshme të modelit 388T, ka deklaruar se katalogu i marrë nga kanali online nuk është dokumentacioni i aplikueshëm për konfigurimin e AGRIBAU, ka konfirmuar autenticitetin e katalogut të AGRIBAU dhe ka konfirmuar në mënyrë të shprehur se makina e ofruar nga AGRIBAU i plotëson të gjitha kërkesat teknike të tenderit.

Nëse AK e konsideron ende të nevojshme, një verifikim i ri dhe i drejtpërdrejtë me personin përgjegjës të prodhuesit, znj. Coral Ma, duke i dërguar asaj ofertën/dokumentacionin konkret të AGRIBAU dhe duke kërkuar konfirmim specifik për këtë konfigurim.

Të kryhet rivlerësimi i ofertës së AGRIBAU SH.P.K. në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me dokumentacionin zyrtar të prodhuesit.



Pretendimi 2.

Ne dosjen e tenderit ju si AK nuk keni kërkuar që Specifikat teknike apo katalogu të jene identike me katalogun i cili gjindet ne web faqen e Prodhuesit e as nuk do te ishte normale qe nje gje e tille te kerkohej. Pasi qe katalogu i qdo prodhuesi ne webfaqe vendoset nje katalog standard dhe reklamues, mirpo nuk kufizon kapacitet e prodhimit tek prodhuesit e pajisjeve ne kete rast Eskavatorve. Prandaj ky arsyetim i juaj eshte i pa bazuar ne ligj dhe ne fakte.

Kërkesa juaj ne dosje te tenderit ishte :

Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet të prezentoj katalogun ose broshuren nga prodhuesi për eskavatorët e kërkuara me këtë dosje të tenderit.

Evidenca 3. Katalogu ose broshura nga prodhuesi për eskavatorët e kërkuara me këtë dosje të tenderit.

Lidhur me keto pretendime, Ekspertja shqyrtuese ne ekspertizen nr. 2026/0181 date 31.03.2026 te ankeses tone date 23.03.2026 ne OSHP, ka dhene sqarimin dhe konstatimin e mjaftueshem ne pretendimin tone nr.1 te ankeses, e qe ky konstatim hedhe poshte arsyetimin e juaj per Eliminimin e OE Agribau SHPK sepse ne kete ekspertize Ekspertja sqaron si me poshte ne raportin 2026/0181 date 31.03.2026:

Përgjigje në pretendimin ankimor 1. Ekspertja shqyrtuese sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, tek kërkesat e “Kapaciteti teknik dhe profesional” AK ka kërkuar: Kapaciteti teknik dhe profesional 2.

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi ose dileri i autorizuar nga prodhuesi për shitjen e eskavatorve të kërkuara me këtë dosje të tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

2. Kopjen e Autorizimit nga prodhuesi ose dileri i autorizuar nga prodhuesi për shitjen e eskavatorve të kërkuara me këtë dosje të tenderit.

Në lidhje me këtë kërkesë të AK-së, OE ankues "AgriBau" shpk -Pejë, së bashku me ofertë ka dorëzuar dokumentin e titulluar: “Katalog 388T Specification,.pdf”, “Dokumentat e prodhuesit.zip”, nënfollderin “NEW AUTHORISATION Shandong Weimeng SKIP.pdf” dhe “Dokumentat e Ofertes.pdf”, ku në këtë dokument është bashkëngjitur një Deklaratë për specifikacione teknike përmes të cilës deklarata OE ankues deklaronte se të gjitha mallrat e ofruara janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara tek Aneksi 1 specifikimet teknike të detyrueshme. Më tej, ekspertja shqyrtuese sqaron se sipas OE ankues, AK nuk e ka marr për bazë dokumentin “NEW AUTHORISATION Shandong Weimeng SKIP.pdf” në të cilin ceket se është diler i autorizuar i prodhuesit.

Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se AK të përgjigjet në kërkesën për informacion shtesë të datës 21.01.2026, ka dhënë sqarime në lidhje me kërkesat e dosjes së tenderit, të cilat sipas LPP-së sqarimet konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit. Në përgjigjen nr. 3 të dhënë nga AK potencohet se “ky kriter mund të dëshmohej jo vetëm përmes manualeve standard teknike të prodhuesit, por edhe përmes deklaratës ose letër konfirmim zyrtar të lëshuar nga prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar, ku konfirmohet përmbushja e këtij kriteri”. Duke pasur parasysh këtë përgjigje të AK-së, nënkuptohet se përmbushja e specifikimeve teknike për të cilat AK e ka eliminuar OE ankues përmbushet përmes një deklarate zyrtare të ofruara nga prodhuesi apo përfaqësuesi i autorizuar duke konfirmuar përmbushjen e standardeve teknike të prodhimit. Në lidhje me sqarimin e dhënë të AK-së të cekur më lart, OE ankues me datë 03.02.2026 dorëzon “Deklaratë për specifikacione teknike” përmes të cilës deklaronte se mallrat e ofruara në listën e përshkrimit të çmimeve janë në përputhje me specifikacionin teknik të kërkuara tek Aneksi 1.

Ne si Agribau SHPK edhe nje here ju sqarojme se:



Në Ofertën tonë sa i përketë specifikimeve teknike kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që ju te keni mundësinë për një vlerësim të drejtë lidhur me këtë Ofertë ku kemi dorëzuar Autorizimin nga prodhuesi si diler i autorizuar, Pra; **OE AGRIBAU SH.P.K.** është diler i autorizuar i prodhuesit të makinës së ofruar, dhe në ofertën tonë kemi dorëzuar specifikimet teknike të pajisjes te nenshkuara dhe te vulosura nga Agribau SHPK (**Diler i Autorizuar i Prodhuesit**) ku janë të përfshira të gjitha karakteristikat teknike të kërkuara nga Dosja e Tenderit.

Perveq se ne kemi bashkangjitur Ofertes; Specifikimet Teknike te nenshkuara poashtu kemi bashkangjitur edhe deklaratën ku jemi zotuar se Oferta jone eshte ne perputhje te plote me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara ne aneksin 1.

Edhe pse disa nga këto specifika nuk janë të paraqitura në katalogun standard të prodhuesit, ato janë të përfshira në **specifikimet teknike të dorëzuara në ofertën tonë**, të cilat përbëjnë dokument teknik zyrtar për pajisjen e ofruar.

Ashtu siq ka Sqaruar edhe Ekspertja Shqyrtues ne Raportin nr. 2026/0181 date 31.03.2026

Në dokumentin zyrtar të Autoritetit Kontraktues "Përgjigje në kërkesën për informacione shtesë" të datës 21.01.2026, Autoriteti Kontraktues në pikën 3. të përgjigjes ka sqaruar se **përmbushja e kriterëve teknike mund të dëshmohet jo vetëm përmes manualeve standarde teknike të prodhuesit, por edhe përmes deklaratës ose dokumentit zyrtar të lëshuar nga prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar**, ku konfirmohet përmbushja e kriterit përkatës.

Në këtë rast, OE AGRIBAU SH.P.K., si **diler i autorizuar i prodhuesit**, kemi dorëzuar pikërisht një dokument të tillë – specifikime teknike të pajisjes që konfirmojnë përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Nga analiza e dokumenteve të operatorit ekonomik të shpallur fitues rezulton se **edhe në katalogun e prodhuesit të këtij operatori mungojnë disa nga specifikat teknike si; Viti i i Prodhimit, GPS (sistemin e monitorimit)** ndërsa Autoriteti Kontraktues ka pranuar si dëshmi dokument shtese per **specifikime teknike të nënshkuara nga prodhuesi.**

Në këtë mënyrë AK ka bërë një **trajtim të pabarabartë i operatorëve ekonomik**, pasi që dokumentet e dorëzuara nga OE fitues janë konsideruar të pranueshme për dëshmimin e specifikave teknike, ndërsa dokumentet e dorëzuara nga OE AGRIBAU SH.P.K., si diler i autorizuar i prodhuesit, nuk janë marrë parasysh gjatë vlerësimit.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha faktet e mësipërme, konsiderojmë se eliminimi i ofertës së AGRIBAU SH.P.K. nuk është i mbështetur në një verifikim të plotë, objektiv dhe të drejtpërdrejtë të konfigurimit konkret të ofruar.

Në veçanti, Autoriteti Kontraktues ka krahasuar dokumentacionin e ofertës së AGRIBAU me një katalog tjetër të modelit 388T, të marrë përmes një personi tjetër, pa u siguruar paraprakisht që personi dhe dokumentacioni i përdorur për verifikim i referoheshin konfigurimit konkret të ofertuar nga AGRIBAU. Ndërkohë, prodhuesi zyrtar SHANMON ka sqaruar se ekzistojnë konfigurime të ndryshme të modelit 388T, ka deklaruar se katalogu i marrë nga kanali online nuk është dokumentacioni i aplikueshëm për konfigurimin e AGRIBAU, ka konfirmuar autenticitetin e katalogut të AGRIBAU dhe ka konfirmuar në mënyrë të shprehur se makina e ofruar nga AGRIBAU i plotëson të gjitha kërkesat teknike të tenderit.

Prandaj pas dergimit te dokumentit zyrtar te dates 01.09.2026 nga personi përgjegjës i prodhuesit SHANMON znj. Coral Ma, i derguar edhe tek AK, të kryhet rivlerësimi i ofertës së AGRIBAU SH.P.K. në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me dokumentacionin zyrtar të prodhuesit.



KËRKESË E VEÇANTË PËR PANELIN SHQYRTUES;

VERIFIKIM I DREJTPËRDREJTË NGA EKSPERTI I OSHP-së ME PRODHUESIN

Për shkak të kontradiktës së drejtpërdrejtë ndërmjet dokumentacionit të përdorur nga Autoriteti Kontraktues dhe konfirmimit zyrtar të prodhuesit SHANMON, AGRI BAU SH.P.K. kërkon që Paneli Shqyrtues i OSHP-së të ngarkojë ekspertin e OSHP-së që të kryejë verifikim të drejtpërdrejtë, të pavarur dhe teknikisht të dokumentuar pranë prodhuesit SHANMON.

Verifikimi duhet të kryhet konkretisht me personin përgjegjës të prodhuesit, z. Coral Ma, në kontaktin zyrtar coral@shanmonkj.com, dhe duhet të bazohet në ofertën konkrete të AGRI BAU SH.P.K., dokumentacionin teknik të dorëzuar në ofertë dhe konfigurimin konkret të makinës së ofruar.

Kërkojmë që eksperti i OSHP-së të verifikojë në mënyrë të veçantë:

1. nëse katalogu dhe dokumentacioni teknik i dorëzuar nga AGRI BAU SH.P.K. në ofertë është autentik dhe i lëshuar/konfirmuar nga SHANMON;
2. nëse konfigurimi konkret i SHANMON 388T i ofruar nga AGRI BAU SH.P.K. është konfigurimi për të cilin është përgatitur dokumentacioni teknik i dorëzuar në tender;
3. nëse konfigurimi konkret i ofruar nga AGRI BAU SH.P.K. i përmbush specifikat teknike të kërkuara në dosjen e tenderit;
4. cilat janë dimensionet reale të konfigurimit konkret të ofruar nga AGRI BAU SH.P.K., veçanërisht gjatësia dhe gjerësia;
5. nëse dimensionet e përmendura nga Autoriteti Kontraktues në katalogun e marrë gjatë verifikimit i përkasin një konfigurimi tjetër të SHANMON 388T;
6. nëse dokumentacioni i marrë nga një agjent online ose person tjetër, i cili nuk është personi përgjegjës i prodhuesit, mund të konsiderohet dokumentacioni teknik zyrtar për konfigurimin konkret të AGRI BAU SH.P.K.;
7. nëse SHANMON konfirmon se AGRI BAU SH.P.K. nuk ka falsifikuar, manipuluar apo teknikisht ndryshuar katalogun/dokumentacionin e dorëzuar në ofertë.

Kërkojmë që eksperti i OSHP-së ta dokumentojë këtë verifikim në raportin e tij, duke identifikuar personin e kontaktuar të prodhuesit, dokumentet e verifikuara dhe përgjigjet konkrete të prodhuesit për secilën nga specifikat e kontestuara.

Kjo mënyrë verifikimi është e nevojshme për të siguruar një vlerësim objektiv dhe të pavarur dhe për të shmangur që vendimi për ofertën e AGRI BAU SH.P.K. të bazohet në specifika të një konfigurimi tjetër të SHANMON 388T.

Pas gjithë asaj që u tha me lart, ne kërkojmë nga Paneli shqyrtues i OSHP-se që bazuar në shpjegimet dhe dëshmitë e dhëna me lart të:

1. Aprovoji ne teresi ankesën tone si të bazuar, duke konstatuar shkeljet ligjore të AK-se për eliminim të kompanisë tone.
2. Të anulohet Vendimi i datës 28.08.2026, dhe Lenda të kthehet në Rivleresim.

Me respekt;
Agribau shpk



date: 14.09.2026

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale janë të konsiderueshme, mirpo nevojitet një ekspertizë financiare dhe profesionale për të konstatuar saktë demet e shkaktuara ndaj kompanisë tone si dhe demet që mund të shkaktohen në qoftë se autoriteti kontraktues vazhdon me dhenjen e kontratës për një operatore që është mbi 18% më e lartë se oferta jone.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- c) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se
- d) Kërkesën për Rishqyrtim datë 02.09.2026
- e) Vendimin për refuzim të AK-se datë 04.09.2026
- f) Konfirmimin e Prodhuesit dhe komunikim me email

